

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

P.nr. 947/2013

25 nëntor 2014

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS, në Trupin Gjykses të përberë nga gjyqtari i EULEX-it Paulo Teixeira – kryetar dhe gjyqtarët e EULEX-it Katja Dominik dhe Franciska Fiser, anëtarë, me pjesëmarrjen e Këshilltarit Ligjor vendor të EULEX-it Dukagjin Kërveshi si procesmbajtës, në lëndën penale P.nr. 947/2013 kundër:

S.I., emri i babait ..., emri i nënës ..., mbiemri i vajzërisë së nënës ..., i lindur më ... në fshatin ..., komuna e Mitrovicës,

i dyshuar për kryerjen e veprave penale “ Vrasje e Rëndë” nga Neni 147, paragrafi 1, pika 1.5 e Kodit Penal të Kosovës (KPK), :Mbajtje në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve” nga Neni 374 paragrafi 1 i KPK në bashkim real me veprën e parë penale dhe “Mosdhënia e ndihmës” nga Neni 191 paragrafi 2 lidhur me Nenin 31 të KPK në bashkim real me veprën e parë dhe të dytë penale.

R.S., emri i babës ..., emri i nënës ..., mbiemri i vajzërisë së nënës ..., lindur më ... në fshatin ..., Komuna e Mitrovicës ,

I akuzuar për kryerjen e veprës penale “Mosdhënia e ndihmës” nga Neni 191 paragrafi 2 lidhur me Nenin 31 të KPK;

Që të dy të akuzuar me Aktakuzën e Prokurorit të Shtetit të datës 18 nëntor 2013 dhe të parashtruar në Gjykatë më 19 nëntor 2013;

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor të hapura për publikun më 03, 04, 05 dhe 06 nëntor 2014, në prani të Prokurorit, të Pandehurve, Avokatit Mbrojtës dhe Palës së Dëmtuar;

Pasi i Pandehuri S.I. është deklaruar fajtor për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve” gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 03 nëntor 2014;

Pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykues mbajtur më 07 nëntor 2014,

Brenda afatit të paraparë kohor (Nenet 366, para. 1, dhe 446 , para. 4 i KPPK).

Më 10 nëntor 2014, sipas Nenet 359 të KPPK shpallë publikisht këtë:

AKTGJYKIM

I. I Pandehuri S.I. shpallet

A- FAJTOR

1.1. Për kryerjen e veprës penale Vrasje nga Neni 178 i KPK,

1.2. dhe në bashkim real me veprën penale Mbajtja në posedim, kontroll apo përdorim të paautorizuar të armëve nga Neni 374 par.1 KPK .

Sepse është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se

Më ... rreth orës ..., në fshatin ., Komuna e Mitrovicës, i pandehuri ka shtënë dy herë me armë zjarri të tipit “TT M-57” , kal. 7.62 mm, ngjyrë e zezë, Prodhim Jugosllav (Crvena Zastava), me numër serik Plumbi i parë ka kaluar pranë viktimës dhe dy shokëve por në një distancë dhe drejtim të panjohur. Predha e dytë është shtënë rreth 10 deri 30 sekonda më pas dhe ka qëlluar pjesën e majtë të shpinës së të ndjerit B.O., dhe predha ka dëmtuar ashtin e tretë të kafazit të brinjëve dhe mushkërinë e majtë, nga i cili i ndjeri B.O. ka rënë në shok hemorragjik (gjakderdhje

masive e brendshme dhe e jashtme). Në ora 01.14 të datës 23/01/2014 ai nuk arriti të ju mbijetojë plagëve (raporti policor i datës 23.01.2013 i policit A. A. Nr. i ID. 7541). I pandehuri S. I. me qëllim ka drejtuar armën në drejtim të tre njerëzve që po vraponin dhe ka shtënë dy herë duke ditur se ai kishte mundësi që eventualisht ta privonte nga jeta të ndjerin B.O., por kishte vepruar me atë dashje eventuale.

Në shtëpinë e tij në fshatin ..., Mitrovicë, deri më ... ishte në posedim të armës së zjarrit – pistoletë e markës “Crvena Zastava” M 57 , kal. 7.62 mm, me numër serik ..., prodhim Jugosllav, pa leje të vlefshme lëshuar nga organi i autorizuar për lëshimin e lejeve për mbajtjen e një arme të tillë.

Ato fakte kanë të gjitha elementet e dy dispozitave të cituara penale dhe nuk është paraqitur ndonjë provë e arsyeshme lidhur me ndonjë motiv të fortë për përdorimin e çfarëdo force ndaj viktimës, dhe aftësia penale e të pandehurit është vërtetuar nga ekspertiza mjekësore e cila ka qartësuar këtë çështje gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Në pajtim me nenin 250 Para. (1) dhe nenin 32 Para. Të KPK

I Pandehuri S.I.

DËNOHET

1. sipas Nenit 374 Para. 1, KPK për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve nga Neni 328 Para. 1, përshkruar nën I.2, me 1 (një) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim;
2. sipas Nenit 178 KPK, për veprën penale Vrasje, me 10 (dhjetë) vjet burgim;
3. sipas Nenit 780 Para. 1 dhe 2, nënpara. 2..2 KPK për të dy veprat e mësipërme S. I. dënohet me dënim unik prej 11 (njëmbëdhjetë) vjet burgim.

I Pandehuri S.I. shpallet

I PAFAJSHËM

Për kryerjen e veprës penale Vrasje e Rëndë nga Neni 179 (1) pika 1.5 e KPK dhe veprës penale Mosdhënia e Ndhmës nga Neni 191 par.2 i KPK¹, dhe i dhe prandaj, i Pandehuri lirohet nga akakuza.

Sepse nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri e kishte ditur se viktima kishte gjakderdhje me rrezik serioz për shëndetin dhe se e shtëna e parë kishte shkaktuar ndonjë rrezik real dhe efektiv për njerëzit tjerë. Gjithashtu se nuk i kishte ofruar ndihmë z. B.O.; dhe se kishte ditur që viktima ishte në rrezik për jetën nga koha e incidentit derisa kishte arritur te shtëpia e familjes së tij.

Andaj elementet e këtyre dispozitave penale nuk janë plotësuar.

II. I Pandehuri R.S.

SHPALLET I PAFAJSHËM PËR KRYERJEN E VEPRËS PENALE Mosdhënia e Ndhmës nga Neni 191 par.2 KPK, dhe prandaj i Pandehuri lirohet nga aktakuza.

SEPSE, NUK ËSHTË VËRTETUAR PËRTEJ DYSHIMIT TË ARSYESHËM SE

Ai nuk i kishte ofruar ndihmë Z. B.O.; se e kishte ditur që viktima ishte në rrezik për jetën nga koha e incidentit deri kur kishte arritur te shtëpia e familjes së tij; se të pandehurit kishin qenë në klubin e bilardos për t'i kërkuar shokët e të ndjerit B.O. përkundër faktit se e dinin se gjendja e tij shëndetësore ishte përkeqësuar; se gjatë rrugës B.O. kishte rënë por i lartpërmenduri nuk e kishte dërguar te mjeku për t'i dhënë ndihmën e parë.

III. Koha e kaluar në paraburgim nga i pandehuri S. I. nga data 23/01/2013 deri në përfundim të asaj mase) do të llogaritet në dënim (Neni 365, para. 1.5 i KPPK).

¹ Ka cekur në procesverbal, ky aktgjykim shprehet vetëm për siguri

IV. Sipas Nenit 69 Para. (1) dhe Nenit 374 Para. (3) të KPK, pistoleta e markës TT M-57”, kal. 7.62 mm, me ngjyrë të zezë, prodhim Jugosllav (Crvena Zastava), me numër serik ... konfiskohet dhe duhet të konfiskohet përgjithmonë nga shteti i Kosovës, sipas nenit 38, n 3 apo 4, të Ligjit për Armët.

V. Kërkesa Pasurore

Pala e dëmtuar është udhëzuar lidhur me të drejtën e saj për të parashtruar kërkesë pasurore sipas Neneve 458, 459 dhe 460 të KPP, por një kërkesë e tillë nuk është paraqitur.

VI. Shpenzimet e procedurës

Sipas Nenit 451 Para. (1) dhe Nenit 453 Para. (1) , (2) dhe (4) KPP, i Pandehuri S.I. duhet të paguaj 200,00 (dy qind) Euro si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale. Duke marrë parasysh se shqyrtimi gjyqësor ka zgjatur vetëm 3 ditë, ai është deklaruar fajtor për njëren akuzë. Sipas nenit 453 parag. 4 KPP, gjykata vendosi që i pandehuri të lirohet nga detyrimi për të paguar pjesën tjetër të shpenzimeve sepse është i papunë dhe ka 4 djem për t’i mbajtur.

Të gjitha shpenzimet (shpenzimet e nevojshme) të të pandehurit R.S. duhet të paguhen sipas nenit 454 të KPPK.

I pandehuri duhet ta paguaj shumën e urdhëruar jo më vonë se 30 ditë nga dita kur ky Aktgjykim të jetë i formës së prerë.

Arsyetim

1. Historia Procedurale

Hetimet perkatëse penale kundër të Pandehurve kanë filluar më 24 janar 2013 me Aktvendimin PP No. 06/2013 Prokurorisë Themelore – Departamenti i Krimeve të Rënda në Mitrovicë për të pandehurin S.I. për veprën penale Vrasje e Rëndë në Tentativë nga nenie 179, para. 1, pika 1.5 e Kodit Penal të Kosovës (KPK), dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve nga neni 374 para. 1

i KPK, dhe për të pandehurin R.S. për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve nga neni 374 para. 1 të KPK,

Më 24 janar 2013 është mbajtur seanca për caktimin e paraburgimit dhe me aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake është aprovuar kërkesa e Prokurorit për shqiptimin e masës së paraburgimit kundër të Pandehurit S.I. në kohëzgjatje prej një muaj nga data përkatëse e arrestimit të tij. Masa e paraburgimit herën e fundit është vazhduar nga Gjyqtari me Aktvendimin e datës 21 tetor 2014.

Të pandehurit akuzohen nga Aktakuza e Prokurorit të Shtetit e datës 18 nëntor 2013 dhe e parashtruar në Gjykatë më 19 nëntor 2013;

Seanca e parë fillestare është mbajtur më 8 shtator 2014, seanca e dytë fillestare nuk është mbajtur. Më 29 shtator 2014, Gjykata ka lëshuar një urdhër për caktimin e datave të seancave të shqyrtimit gjyqësor.

Pastaj, më 19 shtator 2014, prokuroria i ka paraqitur kryetarit të trupit gjykues Propozimin për Kompetencat e Gjykatës me të cilin sfidon kompetencën e gjyqtarëve të EULEX-it për procedurën penale në këtë lëndë, dhe se lënda duhet t'i referohet një trupi gjyqësor në përbërje të gjyqtarëve vendor.

Më 21 tetor 2014, pas afatit për përgjigje nga avokati mbrojtës, Gjykata ka refuzuar Propozimin për Kompetencë të Gjykatës sit ë pabazuar dhe ka vërtetuar Kompetencën e Trupit Gjykues në përbërje të gjyqtarëve të EULEX-it.

Më 27 tetor 2014, Prokurori i EULEX-it ka parashtruar Ankesë në Gjykatën Themelore të Mitrovicës kundër Aktvendimit P.947/13 të Gjykatës Themelore të Mitrovicës të datës 21 tetor 2014 dhe, si kërkesë alternative për diskualifikimin e një Gjyqtari.

Më 28 tetor 2014, kryetari i trupit gjykues ka nxjerr aktvendimin me të cilin konsideron se ankesa e paraqitur duhet t'i dorëzohet gjykatës së Apelit nëse dhe kur paraqitet ankesë kundër aktgjykimit sipas nenit 408, para 3., KPP. Dhe kërkesën për diskualifikim të Kryetarit të trupit gjykues e ka dorëzuar menjëherë të Kryetarja e nderuar e Gjykatës Themelore të Mitrovicës, sipas neneve 39, 40, 41, para. 1, nënpara. 1.1 të KPPK.

Më 30 tetor 2014, Kryetarja e Gjykatës Themelore të Mitrovicës ka lëshuar Aktvendimin GJA. 604/14 me të cilin kërkesën e Prokurorisë themelore të EULEX-it në Mitrovicë të datës 27 tetor 2014 e refuzon sit ë pabazuar.

A. Kompetenca e Gjykatës dhe Përbërja e Trupit Gjykses:

Sipas nenit 23 par. (1) KPP, Gjykatat Themelore kanë kompetencë të dëgjojnë lëndët penale që përfshijnë akuza për të cilat ligji lejon shqiptimin e dënimit prej së pakut 5 vjet burgim. Sipas Nenit 27 (1) KPP, kompetenca territoriale është adekuate për qarkun ku pretendohet se është kryer vepra penale. Vepra penale vrasje në tentativë lejon dënimin prej më tepër se pesë (5) vjet burgim. Prandaj Gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në Gjykatën Themelore të Mitrovicës kanë kompetencë ta dëgjojnë këtë lëndë penale.

Lidhur me çështjen që pretendohet nga prokuroria në tri raste të ndryshme gjykata duhet të theksojë se kjo duket të jetë qëndrim specifik i gjykatës së apelit dhe i të gjithë Gjyqtarëve të EULEX-it se caktimi i lëndëve nga KGJK sipas marrëveshjes ndërmjet Shefit të EULEX-it në Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Aspekte Relevante të Aktivitetit dhe Bashkëpunimit të Gjyqtarëve të EULEX-it me Gjyqtarët e Kosovës që punojnë në Gjykatat Vendore (“Marrëveshja”), është mënyrë ligjore e dhënies së kompetencës. Gjithashtu sipas nenit 5(a) të së njëjtës marrëveshje në Gjykatën Themelore të Mitrovicës ka nevojë që lëndët t’u caktohen gjyqtarëve të EULEX-it për ta mbajtur gjykatëwn operacionale.

Andaj, në të njëjtën çështje, gjykata mbështet aktvendimin që tashmë është nxjerrë më 21 tetor 2014 me arsyetimin e plotë që tashmë është lëshuar.

Gjykata vetëm duhet të shtojë se aktgjykimet e gjykatës së apelit mund dhe duhet të përdoren si precedent në situata normale. Dhe të citoj një vendim të mëhershëm të gjykatës të lëshuar sipas nenit 38 para. 1, KPPK gjatë kohës kur lënda ka qenë në pritje gjykim nga KGJK, është, së pakut, formë jo e drejtë e të kuptuarit të atij aktvendimi.

B. Përmbledhje e Provave të Paraqitura

Gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor janë dëgjuar dëshmitarët në vijim:

1. Z. L.K.
2. Z. F.K.

3. Z. F.F.
4. Z. M.I.(i biri i të pandehurit S.I., që ka shfrytëzuar të drejtën për t'u mbrojtur në heshtje kur është marrë në pyetje)
5. Dr. F.D.(Ekspert- psikiatër i mjekësisë ligjore)
6. Z. M.P..

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor palët janë pajtuar që lista e dokumenteve në vijim do mund të konsiderohej e lexuar apo e ofruar dhe pranuar:

- 1) Raporti Fillestar i Incidentit i datës 23.01.2013, faqe 34 deri 47.
- 2) Raporti Informativ Hetimor (K.P. M.S. #6249), i datës 23.01.2013, faqe 48 to 52.
- 3) Raporti Informativ Hetimor (K.P. M.S. #7398), i datës 23.01.2013, faqe 53 to 55.
- 4) Kallximi Penal (K.P. M.S. #6249 dhe K.P. R.P. #4681), i datës 23.01.2013, faqe 56 to 61.
- 5) Raporti Policor (K.P. A.A. #7514), i datës 24.01.2013, faqe 62 deri 63.
- 6) Raporti Policor (K.P. A.K. #5653), i datës 23.01.2013, faqe 64 deri 65.
- 7) Raporti Hetimor (K.P. M.S. #6249), i datës 23.01.2013, faqe 66 deri 69.
- 8) Raporti Hetimor (K.P. R.P. #4681), i datës 23.01.2013, faqe 70 deri 71.
- 9) Shënimi Zyrtar i Njësisë së Hetimeve (M.S. #6249), i datës 23.01.2013, faqe 72 deri 73.
- 10) Vendimi mbi Paraburgimin, i datës 23.01.2013, faqe 74 deri 75.
- 11) Të Drejtat e Personit të Arrestuar, i datës 23.01.2013, faqe 76 deri 82.
- 12) Memorandumi Zyrtar (K.P. R.P. #4681), i datës 23.01.2013, faqe 83 deri 84.
- 13) Hetimi i së kaluarës për të pandehurin S.I., i datës 23.01.2013, faqe 85 deri 86.
- 14) Vendimi për Autopsi – Prokurore Zejnije Kela, i datës 24.01.2013, faqe 87 deri 88.
- 15) Vendimi për ekspertizë balistike- prokuror Ismet Ujkani, i datës 05.03.2013, faqe 89 deri 90.
- 16) Vendimi për angazhimin e analizave psikologjike- Prokurore Zejnije Kela, i datës 13.08.2013, faqe 91 deri 94.
- 17) Kërkesa për sjelljen e raportit të autopsisë - Prokurore Zejnije Kela, e datës 05.09.2013, faqe 95 deri 96.
- 18) Procesverbali nga seanca dëgjimore për shqiptimin e paraburgimit, i datës 24.01.2013, i datës 97 deri 102.

- 19) Procesverbali nga seanca fillestare, i datës 27.05.2014, faqe 103 deri 106.
- 20) Urdhri për analizë mjekësore nga eksperti, i datës 13.08.2014, faqe 107 deri 112.
- 21) Raporti i Autopsisë (K.P. D.B. #0022), i datës 23.01.2013.
- 22) Raporti nga vendi i ngjarjes (K.P. M.S. #6249), i datës 23.01.2013, faqe 194 to 195.
- 23) Foto Albumi (i Forenzikës), faqe 202 deri 233.
- 24) Raporti i Autopsisë (K.P. A.F. #1782), i datës 23.01.2013, faqe 234 deri 235
- 25) Raporti i Autopsisë (Dr. F. B.), i datës 23.01.2013, faqe 236 deri 245.
- 26) Foto Albumi (Autopsi), i datës 24.01.2013, faqe 246 deri 258.
- 27) Cover Sheet, faqe 259.
- 28) Raporti i ekzaminimit të veturës, i datës 23.01.2013, faqe 260 deri 264.
- 29) Foto Albumi (ekzaminimi i veturës), faqe 265 deri 281.
- 30) Lista e provave, e datës 23.01.2013, faqe 282 deri 287.
- 31) Lista e gjëseneve të sekuestruara, e datës 23.01.2013, faqe 288 deri 289
- 32) Kopja e lejes së qarkullimit, faqe 290.
- 33) Vërtetimi për gjësendet e sekuestruara, i datës 23.01.2013, faqe 291 deri 294.
- 34) Fotografite e gjëseneve të sekuestruara, të datës 23.01.2013, faqe 295 deri 296.
- 35) Lista e gjëseneve të kthyer, e datës 24.01.2013, faqe 297 deri 300.
- 36) Kopja e lejes së njoftimit, faqe 301 to 302.
- 37) Përshkrimi i provave – Laboratori i Forenzikës, e datës 15.03.2013, faqe 303 deri 305.
- 38) Njoftimi për kontrollim në sistemin IMIS, i datës 20.03.2013, faqe 306 deri 317.
- 39) Letra për autorizimin e avokatit, e datës 04. 02. 2014, faqe 308 deri 310.
- 40) Raporti i Psikiatrisë Forenzike për gjendjen shëndetsore mentale të të pandehurit S.I., i datës 22.10.2014
- 41) Kopjet e pranuar nga gjykata vendore lidhur me të kaluarën e të dy të pandehurve.
- 42) Raporti Mjekësor se djali i të pandehurit S.I. vuan nga një smundje mentale dhe nuk është në gjendje normale.
- 43) Përgjigja e ekspertit Dr. F. B. në pyetjen e Avokatit Mbrojtës G. R..

C. DEKLARATA MBI BAZAT

1. FAKTET E VËRTETUARA PËRTEJ DYSHIMIT TË ARSYESHËM

1. Më 22.01.2013 reth orës 23:00 në fshatin Lushtë komuna e Mitrovicës, i ndjeri Bashkim bashk me dy shokët e tij Liridon dhe F.K. ishin duke u shëtitur në rrugë afër shtëpisë së të pandehurit S.I..
2. Ata asnjëherë nuk e kanë lëshuar rrugën dhe as nuk kanë hyrë në pronën e Z. S.I.
3. Para tyre ka ardhur M. I., djali i të pandehurit dhe i ka pyetur: ku po shkoni.
4. Menjëherë pasi që ka ardhur i pandehuri S.I. dhe ka pyetur: “ku po shkoni” dhe ka sulmuar L.K. dhe në një moment L.K. ka arritur të largohet, u ka thënë të tjerëve ikni dhe që të tretë kanë filluar të vraponin në drejtim të fshatit Vaganicë.
5. Gjatë ikjes dy shokët tjerë e kishin tejkaluar Z. B.O..
6. I Pandehuri pas disa sekondash ka filluar të shtënte dy (2) herë në drejtim të tyre me një armë zjarri të markës “TT M-57”, të kalibrit 7.62 mm, me ngjyrë të zezë, prodhim Jugosllav (CrvenaZastava), me numër serik ..
7. Plumbi i parë ka kaluar afër viktimës dhe dy shokëve(L.K. dhe F.K) por në një distancë dhe drejtim të panjohur.
8. Predha e dytë është shkrepur 10 deri 30 sekonda pas të parës dhe ka qëlluar anën e majtë të shpinës së të ndjerit B.O., dhe predha ka dëmtuar ashtin e tretë të kafazit të brinjëve dhe mushkërinë e djathtë (gjakderdhje masive e brendshme dhe jashtme).
9. Në ora 01.14 të datës 23/01/2014, nuk arriti t’u mbijetojë plagëve .
10. I pandehuri S. I. me dashje ka drejtuar armën kah tre njerëzit që po iknin dhe ka shtëntë dy herë duke ditur se kishte mundësi që ta privonte nga jeta të ndjerin B.O., por ka vepruar me dashje eventuale.
11. Në shtëpinë e tij në fshatin ..., Mitrovicë, nga viti 2008 deri më 23.01.2013 ka qenë në posedim të armës së zjarrit – pistoletë e markës “Crvena Zastava” M 57 e kalibrit 7.62 mm, me numër serik ..., prodhim Jugosllav, pa leje të vlefshme lëshuar nga organi i autorizuar për mbajtje të një arme të tillë zjarri.
12. Z. Sabit Strefi është i papunë, ka pesë djem të moshës 21, 18, 17, 14, dhe 9 vjeçare, i martuar për herë të dytë, nuk ka veturë por ka shtëpi ku jeton me familjen e tij.
13. Njëri nga djemët e tij vuan nga Hypophernia

14. S.I. është person me një çrregullim mendor i quajtur çrregullim anti-social dhe i personalitetit, i koduar me emrin e kodit F 60.02 sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve ICD-10.
15. Ai është çrregullim që karakterizohet me tendencë drejt sjelljes impulsive pa pa menduar për pasojat/ nuk mëson nga vuajtjet/ disponim i ndryshueshëm dhe i paparashikuar, tendencë për tejmbushje emocionale, sjellje konfliktuozë dhe situata trazuese në drejtim të të tjerëve.
16. Ai ka aftësi të zvogëluar por jo në nivel substancial për t'i kuptuar veprimet e tij dhe për ta kuptuar peshën e veprës për të cilën akuzohet dhe ka qenë i aftë të marrë pjesë në procedurën gjyqësore.
17. Z. S. I. është paraqitur në shqyrtimin gjyqësor dhe është shpallur fajtor për këto vepra penale: Në lëndën P. 180/06 për veprat penale nga nenet 260/1 dhe 153/2- Ai është dënuar me aktgjykim të formës së prerë të datës 20/04/2007 me një gjobë prej 400 euro. Në lëndën P. 43/02 për veprat penale nga neni 135/1.1 i Kodit Penal të Kosovës me tre muaj burgim me aktgjykim të formës së prerë të datës 16/09/2002.
18. I pandehuri S.I. me rastin e ndërmarrjes së veprimit të paligjshëm shtënje me pistoletë në të ndjerin B.I. në shpinë nga pas duke i shkaktuar atij lëndime me çrast ai ishte rrëzuar në tokë.
19. I Pandehuri S.I. pasi kishte zënë të ndjerin B.O., kishte thirrë R.S. në telefon për të kërkuar ndihmë dhe i ka thënë: “Kam zënë një nga hajnat dhe të tjerët kanë ikur”.
20. I Pandehuri Ramadan me veturën e tij WV me ngjyrë të gjelbërt me targa ... ka shkuar te S.I., dhe e kanë vendosur atë në ulësen e prapme të veturës së R.S., dhe R.S. ka ngarë veturën, ndërsa S.I. i ka thënë R.S. që të shkojë në klubin “Pools club” në Shipol.
21. Në atë vend ata kanë biseduar me Z. M.P. dëshmitar dhe nga ai kanë kërkuar që ta thërras familjen e viktimës.
22. Pas kësaj, S. I. ka folur në telefon me Z. F.F. dhe me bashkë të pandehurin R.S. që po ngiste veturën dhe viktimën e kanë dërguar te shtëpia e familjes së tij rreth orës 00:30.

23. Në atë vend Z. F.F. në fillim ka supozuar se ishte në shok për shkak të frikës, por pastaj ka kuptuar se ai ishte në frymëmarrjen e fundit.
24. Pastaj, ai u ka thënë të pandehurve dhe të gjithë ata kanë hyrë në veturë dhe derisa Z. R.S. po ngiste veturën shumë shpejt për në spital dëshmitari është munduar t'i jepte rianimimin gojë më gojë viktimës B. O..
25. Viktima është sjellë në spital rreth orës 00.45 nga të pandehurit dhe dëshmitari F.F.. (Raporti policor i datës 23.1.2013, faqe 0053 në shkresat e lëndës).
26. Me atë rast mjeku i ka thënë dëshmitarit Z. F. F. se viktima ka shansë 50/50 për të mbijetuar.
27. Gjaku i plagës së viktimës nuk dukej në rrobat e tij nga vështrimi i jashtëm (deklaratat e dëshmitarëve 3 dhe 4)). 1
28. I pandehuri R.S. është i martuar dhe ka njëmbëdhjetë djem.
29. I Pandehuri R.S. ishte i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor dhe është shpallur fajtor për veprën penale në vijim: në lëndën P.224/05 Lëndim i lehtë Trupor nga neni 153/2-2 i KPPK . Ai është dënuar me aktgjykim të formës së prerë të datës 15/01/2007 me gjashtë muaj burgim dhe dënimi nuk do të ekzekutohet nëse ai nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale në dy vitet e ardhshme.

II- FAKTET QË NUK JANË VËRTETUAR PËRTEJ DYSHIMIT TË ARSYESHËM

1. Se i pandehuri S.I. menjëherë i ka rënë shuplakë dhe e ka sulmuar L.K., e ka kapur për fyti dhe se i pandehuri e ka ndjekur të ndjerin dhe dy shokët e tyre.
2. Se i paneduri S.I. kishte shkrepur më shumë se dy të shtëna.
3. Se pak kohë pas së shtënës B.O. kishte vdekur,
4. Se i pandehuri S.I. me të shtënat ka vënë në rrezik edhe jetën e F.K. dhe L.K. të cilët ishin bashk me të ndjerin B.O..
5. Se i pandehuri Sabit kishte dashje të drejtpërdrejt për ta vrarë viktimën.
6. Se ata nuk i kishin dhënë ndihmë Z. B.O..

7. Se dy të pandehurit e kanë ditur se viktimja ishte në rrezik për jetë nga incidenti deri sa kanë arritur te shtëpia e familjës së tij.
8. Se dy të pandehurit kanë qenë në klubin e bilardos për t'i kërkuar shokët e të ndjerit B.O. përkundër faktit se e dinin që gjendja e tij shëndetësore po përkeqësohej.
9. Se gjatë tërë rrugës B.O. kishte rënkuar, por të lartpërmendurit nuk e kishin dërguar te mjeku për t'i dhënë ndihmën e parë.
10. Se për shkak të kësaj (mungesës së ndihmës) ai kishte vdekur pak kohë më vonë.
11. Se i pandehuri S.I. kishte shtënë vetëm nga pakujdesia pa e ditur se ai do mund të vriste ndokënd (fakt që pretendohet nga mbrojtja shqyrtimit gjyqësor).

III- ARSYETIMI FAKTIK

Sipas nenit 3 të KPP prezumimi i pafajësisë “*përcakton se prokuroria mban barrën e vërtetimit të akuzës, garanton se nuk mund të pruzmohet asnjë fajësi derisa të mos vërtetohet fajësia përtej dyshimit të arsyeshëm [dhe] siguron se dyshimi interpretohet në favor të të akuzuarit*”.

Ky standart “*kërkon gjetjen e faktit për tu bindur se nuk ka shpjegim të arsyeshëm të provës përveç fajësisë së të akuzuarit*”.

1. Lidhur me akuzën e vrasjes i pandehuri kurrë nuk e ka mohuar se ai kishte shtënë kundër viktimës.

Me raportin mjekësor të autopsisë gjykata mund të vërtetojë sigurtë se vdekja ishte shkaktuar nga ajo e shtënë (ato kanë qenë të vetmet të shtëna që janë shkrepur në atë kohë dhe në atë vend).

Deklaratat e të dy dëshmitarëve (L.K. dhe F.K.) ishin bindëse dhe të besueshme përkundër disa mospërputhjeve të natyrëshme. Ekzistojnë disa dallime dhe mospërputhje në dëshmitë e dëshmitarëve. Ato kryesisht kanë të bëjnë me matjen e distancës dhe kohën. Megjithatë, për mendimin e trupit gjykues ato kanë rezultuar nga kalimi i kohës dhe

perceptimi dhe kujtesa e natyrshme njerëzore e papërkryer. Në të vërtetë, këto dallime dhe mospërputhje kanë siguruar trupin gjykues se dëshmitë ishin plotësisht spontane dhe se nuk kishin qenë paraprakisht të përgaditura nga dëshmitarët.

Ata kanë deklaruar se kanë qenë në rrugë pa asnjë veprim të shkelës dhe pas një bisede të shkurtër ata kanë vrapuar dhe pastaj ata kanë dëgjuar një të shtënë që ka shkuar në distancë dhe drejtim të panjohur. Pak sekonda më pas e shtëna e dytë dhe menjëherë Bashkimi është rrëzuar dhe nga ai ka ardhur një zë si "Of".

Z. L.K. ka deklaruar: *"Ne jemi ndalur, ai ka ardhur dhe na ka thënë çka po lypni në këtë rrugë. Pastaj ka ardhur babai i tij duke vrapuar, më ka kapur mua për krahu këtu dhe më ka rënë shuplakë. Ne të tret pastaj kemi filluar të ikim dhe ai ka shtënë dy herë. Herën e parë e kemi dëgjuar plumbin që ka ardhur kah koka jonë dhe herën e dytë plumbi ka goditur B.O.. Pastaj kemi ikur dhe kemi shkuar në polici për ta lajmëruar rastin".*

Dhe *"Ai ka qenë duke udhëhequr në fillim dhe më vonë ne kemi ardhur në vijë të njëjtë, pastaj F.K. ka vrapuar dhe ka marrë pozicionin e njëjtë aty ku ishte B.O. i në atë kohë, dhe pastaj B.O. është shtyrë prapa për rreth një metër, e kemi dëgjuar kur ka shtënë një herë; plumbi ka fluturuar afër kokave tona dhe plumbi i dytë e ka goditur B.O. në shpinë"*

Z. F.K. ka deklaruar se e kishte ditur që viktima ishte lënduar *"sepse kishte bërë titur. Ai vetëm rënkonte 'Oh'".* Dhe se *"Ne po ecnim. Pastaj kishte ardhur ai pas shpinës sonë duke sharë, me kërcënime, kësaj here kishte goditur L.K.. Pastaj kishte filluar të vraponte posa ishte goditur. L.K. kishte villuar të vraponte, pastaj menjëherë pas tij B.O. kishte vrapuar pas tij, pastaj kam vrapuar dhe unë, pastaj ai menjëherë ka shtënë një herë, dhe posa e kam tejkaluar B.O., pastaj me të shtënën e dytë e kishte qëlluar atë".*

Andaj gjykata ka mundur të vërtetojë të gjitha elementet objektive të veprës penale përtej dyshimit të arsyeshëm.

Nuk është paraqitur ndonjë provë e arsyeshme (përveç deklaratës paraprake të të pandehurit) lidhur me ndonjë motivë të fortë për përdorimin e çfardo lloji force kundër viktimës. Në këtë çështje duhet të theksojmë se gjykata ka thirrë djalë të pandehurit për të sqaruar atë fakt por ai zgjedhur të mos flasë.

Dhe deklarata e dëshmitarëve është shumë e qartë dhe bindëse. *“Kryetari i Trupit Gjykses: Gjatë natës a keni kaluar tokën e të pandehurit S.I.? L.K.: Jo, absolutisht jo, nuk kemi dalë fare nga rruga. Kryetari i Trupit Gjykses: A jeni afruar te shtëpia e Sabitit? L.K.: Jo. Kryetari i Trupit Gjykses: Kurr nuk e keni lëshuar rrugën publike? L.K.: Jo kurrë, vetëm kemi vazhduar përpara”*.

Aftësia kriminale e të pandehurit është vërtetuar nga ekspertiza mjekësore e cila ka sqaruar atë çështje gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Eksperti mjekësor sqaron *“ I kam shpjeguar prokurorit. Vetëdija e tij apo gjykimi i tij, tempore criminis, për momentin e veprimit, aftësia e gjyqimit për të gjykuar drejtë ishte e zvogëluar, gjithashtu e njëjta aftësi për ta ndalur dorën që të mos shtënte ishte e zvogëluar. Ekziston edhe një motiv patologjik sepse nëse e nxjerr armën ekziston mundësia për të shtënë në dikend. Në piken B, ne e kemi përshkruar diagnozën e këtyre çrregullimeve. Ai përfshihet në atë pikë për shkak të të gjitha rrethanave, veprimet e tij kanë qenë vazhdimisht të brishta”*. Dhe së fundi *““Ai është i rrezikshëm vetëm në rrethana që nuk janë në favor të tij; në situata kur prishet personaliteti i tij, kur ai irritohet, kur shkak është i parëndësishëm dhe reagimi i tij dërrmues. Ato nuk janë racionale; ato janë iracionale; irracionalja është antisociale”*.

Sa i përket dashjes reale të të pandehurit kur ka shtënë me armë , gjykata ka marrë në konsideratë faktin se po të donte i pandehuri S. I. ta vriste viktimën, ai ka mundur ta bënte këtë lehtë kur B.O. ka qenë i shtrirë në tokë. Gjithashtu siç ka deklaruar dëshmitari F..F. kur po vraponin për në spital, i pandehuri i kishte thënë atij që ta shpëtonte viktimën. Andaj sjellja pas të shtënave zbulon dhe shpjegon dashjen e Z. S.I..

Por gjykata duhet ta refuzojë mundësinë e vrasjes nga pakujdesia sepse çdokush (*normal bonus pater familias* apo personi i arsyeshëm) që përdor armë (dy herë dhe për disa sekonda) në drejtim të tre njerëzve duhet ta dijë se ka mundur ta vriste dikend. Dhe në këtë rast i pandehuri zbulon se dashja konkrete për të shtënë jo njëherë por dy herë në drejtim të 3 njerëzve (po të ishte dashja frikësimi i tyre, deklarata faqe114) atëhere ai do të kishte shtënë në ajër jo në drejtim të njerëzve.

Gjykata duhet të theksojë, përfundimisht, se sipas deklaratës së Z. L.K. ne gadi mund ta vërtetojmë dashjen e drjetpërdrejtë të vrasjes (por vetëm njëri nga dy dëshmitarët i referohet asaj britme precize, që për shkak të saj nuk është plotësisht e sigurt)

Kryetari i Trupit Gjykses: A ju ka thënë S.I. apo ndokush diçka në atë moment? L.K.: Ai na ka sharë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Thuaj fjalët konkrete që i ka përdorur. L.K.: Ai ka thënë: ‘nalnu aty, ju të qimit e nënës’.

Kryetari i Trupit Gjykses: Më thuaj, a ka qenë në atë vend edhe djali i S.I.t, a ka thënë ai diçka apo jo? L.K.: Po ka qenë aty dhe ka thënë: ‘babi gjuaj’ ”

Argumenti lidhur me trajektoren e plumbit është sqaruar nga informata e dytë mjekësore që është marrë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në këtë rast trajektorja është adekuate sepse i pandehuri ka mundur të shtënte me armën e tij në një pozitë më të ultë se sa normale, dhe është lëvizje e natyrshme e çdo njeriu që të kërruset pasi të dëgjoj një të shtënë me armë.

Përveq asaj që u tha më lart, situata e rrezikut për njerëzit tjerë nuk mund të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm sepse asnjë dëshmitar nuk ka mundur të deklarojë se sa ishte distanca dhe cili ishte drejtimi i plumbit të parët. Ata vetëm e din se “ kishte kaluar mbi kokën e tyre”, dhe nuk kanë mundur ta precizojnë atë distancë. Gjithashtu gjykata e din se vendi ishte fushë e hapur me drunjë andaj mundësia e rikoshesë ishte e vogël. Prandaj ne nuk mund të vijmë në përfundim me ndonjë besueshmëri se ka pasur ndonjë rrezik real.

Sa i përket rrethanës rënduese për shkak të trajtimit mizor.

Kjo rrethanë rënduese nuk ishte në aktakuzë dhe nuk mbështetet nga asnjë deklaratë e dëshmitarëve. Z. F.F. ishte shumë i qartë. Ai vetë në fillim kishte menduar se viktimi ishte në shok. Andaj gjykata nuk ka asnjë element të fortë për ta cilësuar udhëtimin me viktimën në veturë si dashje reale për shkaktimin e vdekjes në mënyrë mizore.

3. Sa i përket veprës penale të përdorimit të armës trupi gjykses ka vendosur për shkak të pranimit të fajësisë nga i pandehuri i cili ka pranuar këto fakte dhe të raportit balistik.

4. Data e vdekjes është bazuar në raportin policor të datës 23.01.2013 të zyrtarit policor A. A., nr. i ID 7541.

Sëmundja e djalit të të pandehurit është bazuar në raportin mjekësor të datës 28/10/2014, që është paraqitur si provë materiale gjatë shqyrtimit gjyqësor nga mbrojtja.

Dënimet penale bazohen në të dhënat kriminale të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor që janë pranuar nga të dy të pandehurit.

Elementet socio-ekonomike janë vërtetuar me deklaratat e dëshmitarëve.

ARSYETIMI LIGJOR

1. Ligji i Aplikueshëm

Substancialisht, kjo lëndë vendoset me KPK sepse ngjarjet kanë ndodhur më 22/01/2013 dhe prandaj aplikohet kodi aktual KPP (kodi nr. 04/l-082)..

2. Akuza e Vrasjes

I pandehuri akuzohet për veprën penale vrasje në tentativë.

Neni 178 i KPK thotë: *“Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim”*.

Neni 179 i të njëjtit kod thotë se dënimi do të jetë i rëndë jo më pakë se dhjet vjetë (...) nëse personi: *“privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose më shumë personave tjerë”* (para. 1.5).

Vrasje të rënda konsiderohen ato vrasje që kryhen në rrethana të rënda. Në rastet e vrasjes së rëndë është e pranishme një shkallë më e lartë e joligjshmërisë dhe e fajësisë së kryerësit të veprës. Në rastin e para. 1.5. rrethanë rënduese i referohet mënyrës së kryerjes së veprës (rrezikimi i jetës së të tjerëve).

Por nga faktet e vërtetuara gjykata nuk ka mundur të vijë në përfundim se plumbi i shkrepur nga i pandehuri kishte vënë në rrezik real dhe konkret Z. L.K. dhe Z. F.K.. Në

rend të parë për shkak se distanca dhe drejtimi i asaj të shtëne është i panjohur. Për këtë shkak gjykata nuk ka mundur të deklarojë se trajektorja ka qenë afër trupit të ndonjë personi. Prandaj trupi gjykues nuk ka mundur të vijë në përfundim se është plotësuar dispozita e paragrafit 1.5 të KPK, sepse gjykata nuk ka mundur ta vërtetojë nëse veprimi i të pandehurit ka sjellur rrezik immanent për ndonjë person.

Në fjalën përmbyllëse prokuroria ka kërkuar dënimin për të pandehurin gjithashtu edhe sipas paragrafit 1.4.: *“privon nga jeta personin tjetër në mënyrë mizore apo dinake”*.

Domethënja ligjore e mënyrës mizore është zakonisht përdorimi i forcës së tepruar fizike kundër një personi që shkakton vuajtje madje edhe nëse ai person nuk pëson lëndim të rëndë. Ky veprim ka mundur të bëhet përmes çdo lloj veprimi madje edhe psikologjik. Megjithatë në këtë rast faktet nuk e mbështesin asnjë lloj të sjelljes mizore nga i pandehuri. Udhëtimi më veturë me të pandehurin nuk është formë e shkakimit të vuajtjes së viktimës por formë (sigurisht e gabuar) e gjetjes së familjes së tij².

Për këtë shkak trupi gjykues duhet të vijë në përfundim se rrethana rënduese e kësaj vrasje nuk është përmbushur.

Sa i përket veprës penale të vrasjes, elementet objektive të veprës penale janë:

- a) personi me mendje të shëndoshë dhe diskrecion (d.m.th personi i shëndosh);
- b) vrasjet apo tentimet për vrasje të paligjshme (d.m.th. . jo vrasje në vetë mbrojtje apo ndonjë vrasje tjetër e arsyeshme);
- c) çdo qenje e lindur njerëzore;
- d) me dashje për të vrarë.

Dashja e kërkuar për vrasje mund të dëshmohet nga rrethanat faktike neni 22 i KPK dhe nga vendimi në gj. Angleze i R v. Walker dhe Hayles (1990) 90 Cr App R 226).

Në këtë rast faktet e vërtetuara lejojnë që gjykata të vjen në përfundim se i pandehuri kishte dashje eventuale për ta vrarë viktimën. Ai ka drejtuar armën dhe ka shtëne dy herë,

² Shih mjetin paralel ligjor të torturës në nenin 149/2/2.5 KPK “shkaktimi me dashje I dhimbjes së fortë apo vuajtjes, qoftë fizike apo mendore (...).

së pakut njërën, në drejtim të viktimës. Prandaj është e qartë se ai ka dashur ta kryej veprimin dhe çdokush (çdo person i arsyeshëm) do mund ta dinte se plumbi kishte mundësi të shkaktonte vdekje. Gjithashtu gjykata duhet të theksojë se i pandehuri kishte trajnim ushtarak (intervista e raportit mjekësor) dhe njohuri që kishte përdorur armën për shumë vite. Andaj Gjykata vjen në përfundim se i pandehuri ka vepruar me dashje eventuale (neni 21 KPK) dhe jo nga pakujdesia e vetëdijshme apo pavetëdijshme (neni 23 i të njëjtit kod).

Sa i përket përgjegjësisë penale të të pandehurit, është vërtetuar se ai kishte një çrregullim mendor të quajtur çrregullim anti social dhe persoanaliteti që kodohet me emrin kodues F 60.02 sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të sëmundjeve ICD-10.

Gjendja e njohur mjekësore mund të gjendet në listat e kënaqëshme të pranuar që së bashku përfshijnë kushtet e njohura fizike, psikiatrike dhe psikologjike. Këto janë , aktualisht, Klasifikimi Ndërkombëtar i Sëmundjeve i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (ICD-10) dhe Noracaku Statistikor dhe Diagnostifikues i Çrregullimeve Mendore i Shoqatës Psikiatrike Amerikane (DSM-IV).

Megjithatë në këtë rast *“ai është çrregullim që karakterizohet me tendencë drejt sjelljes impulsive pa menduar për pasojat/ nuk mëson nga vuajtjet/ disponim i ndryshueshëm dhe i paparashikuar, tendencë për tejmbushje emocionale, sjellje konfliktuoze dhe situata trazuese në drejtim të të tjerëve”*.

Për shkak të kësaj është e sigurt se i pandehuri është i shëndosh dhe penalisht përgjegjës.

Së pari për shkak se ekziston konkluzioni mjekësor *“Ai ka aftësi të zvogëluar por jo në nivel substancial për t'i kuptuar veprimet e tij dhe për ta kuptuar peshën e veprës për të cilën akuzohet dhe ka qenë i aftë të marrë pjesë në procedurën gjyqësore.”* Së dyti se jonormaliteti i funksionimit mendor do të duhej të kishte parandaluar aftësinë e të pandehurit që t'a

- a) kuptojë natyrën e sjelljes së tij
- b) formojë një gjykim racional;
- c) ushtroj vetë kontrollin

Në këtë rast të gjitha ato elemente plotësohen dhe prandaj gjykata duhet të vijë në përfundim se i pandehuri ka kryer veprën penale me aftësi të zvogëluar mendore por jo me pa zotësi mendore (neni 18/2 KPK).

Vetë mbrojtja

Kjo linjë e mbrojtjes duket të jetë tepruar nga i pandehuri.

Megjithatë gjykata thekson se nuk janë plotësuar elementet e mbrojtjes së nevojshme (neni 12 KPK). Ajo dispozitë përcakton “*Mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm ndaj vetes ose personit tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi*”.

Pra ligji penal i Kosovës pranon se ka rrethana të caktuara në të cilat përdorimi i forcës, madje edhe force vdekjeprurëse, kundër një personi tjetër mund të jetë e nevojshme dhe e arsyeshme. Por në këtë rast nuk është ashtu. Sjellja e të pandehurit nuk plotëson parimet e mbrojtjes së nevojshme.

Së pari nuk është vërtetuar se viktima ka bërë ndonjë veprim agresioni. Pastaj sipas fakteve ishte i pandehuri ai që kishte bërë veprimin e parë dhe të vetëm të agresionit. Andaj parimi i pafajësisë nuk është plotësuar. Parimi i pafajësisë i referohet nocionit që një person i cili fillon një konflikt nuk mund të pranohet që më vonë të arsyetojë përdorimin e forcës nga ai si vetëmbrojtje. Është ky parim që përfshihet në nenin 12/2 KPK “*ta zbraps sulmin e kundërligjshëm*”.

Së dyti, parimi i imanencës i referohet nocionit që ju mund ta mbron veten me forcë kundër rrezikut kërcënues që do të ndodhë (MU TANI). Askush nuk mund ta përdor forcën për të parandaluar një rrezik që mund të paraqitet në një kohë më vonë- ligji pret që çdo person i arsyeshëm të kërkojë një zgjidhje alternative në ndërkohë, siç është thirrja e policisë.

Në këtë rast çdo sulm real dhe i aty-për-atyshëm është vërtetuar, përkundrazi faktet zbulojnë se të tre shokët kurrë nuk e kanë lëshuar rrugën.

Por edhe sikur të ishte vërtetuar se viktimi kishte tentuar ta dëmtonte pronën e të pandehurit është e qartë se parimi i përpjestueshmërisë do të ishte shkelur.

Parimi i Përpjestueshmërisë i referohet nocionit që masa e forcës që mund ta përdorësh për vettëmbrojtje duhet të jetë në përpjestim me shkallën e forcës me të cilën kërcnohesh. Briefly, një kërcenim jo-vdekjeprurës mund të kundëvitet me një mbrojtje jo-vdekjeprurëse. Kërcnimi që ka mundësi të shkaktojë vdekjen apo lëndim të rëndë trupor (p.sh. ashti i thyer, prita, dhunimi) mund të përputhet me forcën vdekjeprurëse. Në këtë rast, viktimi ka qenë e pa armatosur, në të është shtënë në rrugë publike kur ishte duke ikur. Andaj, është evidente se çdo përdorim i çfarëdo lloj arme zjarri ishte qartazi joproporcionale.

Prandaj, gjykata vjen në përfundim se mbrojtja e nevojshme nuk është e aplikueshme në këtë rast.

Asnjë fakt nuk është pretenduar as vërtetuar lidhur me ekzistencën e lajthimit faktik (neni 25 of KPK).

3. Akuza për mbajtje të paautorizuar të armës në pronësi.

Neni 374 KPK thotë se *“Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje të ligjit të zbatueshëm për armë të tilla, dënohet me gjobë (...) ose me burgim deri në pesë (5) vjet”*.

Sipas përkufizimit ligjor të armës (ligji për armët – Ligji nr. 03/L-143 dhe neni 120/38 KPK) pistoleta të cilën e ka përdorur i pandehuri është armë.

Andaj të gjitha elementet e veprës penale janë përmbushur sepse i pandehuri ka pranuar se e dinte natyrën e asaj arme dhe detyrimin ligjor për marrjen e lejës (neni 4/1/1.2. kategoritë b të ligjit për armët).

Së fundi gjykata thekson se kjo veprë penale nuk është në dispozitën e Ligjit nr. 04.L-209 neni 3 i të cilit thotë *“të gjithë kryerësve e veprave të dhëna në nenin 3 të këtij ligji që janë kryer para datës 20 qershor 2013 do t’u lejohet përjashtimi nga ndjekja penale”*.

Vepra penale është kryer në janar të vitit 2013, dhe përdorimi i asaj arme ka shkaktuar një vdekje. Andaj ligji për amnesti nuk është i aplikueshëm.

4. Vepra penale mosdhënia e ndihmës

Neni 191 i KPK thotë se *“kushdo që nuk i ofron ndihmë personit jeta e të cilit ndodhet në rrezik të drejtpërdrejtë, edhe pse këtë ka mundur ta bëjë pa rrezik të madh për veten apo tjetrin, dënohet me burgim deri në një vjet”*.

Kjo dispozitë, sikur gadi çdo ligj civil i jurisdikcionit Evropian, vërteton *“ligjin e keq Samaritan”* apo detyrën për të shpëtuar.

Në rastin e Ligjit të Kosovës kërkohet që viktimat të ketë vuajtur apo se pritej se do të vuaj lëndim të rëndë. Por ai rrezik duhet të jetë kuptuar nga të pandehurit apo që ai rrezik serioz të jetë kuptuar nga një person i arsyeshëm në rrethanat e të pandehurit.

Në këtë rast, gjykata duhet të konkludojë se të pandehurit nuk kanë kuptuar rrezikun serioz për jetën e viktimës. Së pari ata nuk kanë parë kurrëfar gjaku. Së dyti se çdokush që ka parë viktimën në atë periudh (dëshmitarët F.F. dhe M.P.) nuk kanë ardhur në përfundim se ai ishte në situatë të rrezikut për jetën. Së fundi sepse posa e kanë ditur ata e kanë dërguar shumë shpejt në spital (shih deklaratat e Z. F.F.).

Andaj gjykata konkludon se ky element i veprës penale nuk është përmbushur dhe prandaj i liron nga akuza të dy të pandehurit.

Por gjykata duhet të vë në dukje se dispozita e paragrafit 2 nuk ka mundur të zbatohet për të pandehurin R. S. sepse ai nuk ka qenë kryerës as bashkë-kryerës i veprimit (shtënies me armë). Dhe së dyti ekziston një relacion i bashkimit të veprave penale ndërmjet dispozitës së nenit 191/4 KPK dhe veprës penale të vrasjes³.

³ Shih zbatimin e përgjithshëm të rregullave mendimin ligjor të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 07/05/2014 lidhur me veprën penale nga neni 318 dhe 305 KPK.

Bashkimi real i veprave penale lind kur i akuzuari kryen më shumë se një vepër penale, qoftë duke shkelur inkriminimin e njëjtë disa herë, qoftë duke shkelur një numër të veprave të ndryshme penale me veprime të ndara.

Bashkimi i qartë real mund të lind kur një sërë veprimesh të ndara por që lidhen ngusht me njëra tjetrën përmbushin të gjitha elementet e inkriminimit të caktuar, por konsiderohen si një e vepër e vetme, megjithëse në vazhdim. B.O. ideal i referohet situatës ku një veprim i vetëm apo situatë faktike shkel më shumë se një vepër penale.

Dhe bashkimi i qartë ideal i veprave lind kur lidhja e bashkëveprimit zgjidhet me zbatimin e metodave tjera analitike. Pika fillestare e kësaj analize është krahasimi i elementeve të ndryshme të veprave penale në mënyrë që të përcaktohet veçantia reciproke. Parimi i konsumimit (*lex consumens derogat legi consumptae*) zbatohet si metodë shtesë për të përcaktuar përshtatshmërinë e dënimeve kumulative për bashkimin ideal. Konsumimi u referohet lidhjeve ndërmjet veprave të një lloji, por të rëndesisë dukshëm të ndryshme, që janë krijuar për të mbrojtur intereset e njëjta apo ngushta shoqërore, por që dallojnë sa u përket elementeve të veçanta. Në rrethana të tilla, veprat më të rënda konsumojnë veprat më të lehta. Në mënyrë të ngjajshme, format më serioze të pjesëmarrjes konsumojnë format më pak serioze, ashtu që kryerja e drejtpërdrejtë e veprës penale do ta konsumonte nxitjen apo ndihmën dhe madje edhe format e përgjegjësive superiore.

Në aktakuzë, megjithatë, Prokurori ka përdorur parimin e bashkimit real të qartë për qëllimin e padukshëm. Për një veprim i pandehuri akuzohet për dy vepra penale edhe pse neni 191 KPK ka një dispozitë të veçantë (paragrafi 4) që dënon vdekjen e shkaktuar nga mosdhënia e ndihmës.

Andaj rezultati i njëjtë (vdekja) përdoret në dy dispozita të ndryshme.

Në këtë pikëpamje gjykata vjen në përfundim se i pandehuri S. I. nuk ka mundur të shpallet fajtor për dy veprat penale sepse neni 191 KPK është bashkëveprim të dukshëm me veprën penale të vrasjes përmes parimit të konsumimit.

5. Caktimi i dënimit.

Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata është e obliguar të vlerësojë të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues sipas nenit 73, 74 dhe 75 të KPK. Shtrirja kryesore e dënimit bazohet në nevojën e zbatimit kriminal dhe përpjestueshmërisë së nivelit të rrezikut për të drejtat e njeriut, liritë dhe vlerat shoqërore (neni 1, para. 2 KPK).

Trupi gjykues gjithashtu ka vënë në dukje se rezulton që veprat e ndryshme penale që përfshijnë përdorimin e armëve të zjarrit kryhen më shpesh në Kosovë, kohët e fundit. Kjo seriozisht ndikon në rendin publik dhe sigurinë personale të njerëzve në Kosovë; prandaj, dënimi për këtë lloj të veprës penale shërben si parandalues i përgjithshëm për të gjithë kryerësit e mundshëm të veprave penale.

Trupi gjykues ka marrë në konsideratë këta faktorë rëndues:

Moshën e viktimës dhe motivin e veprës penale. Faktin që ai ka shtënë me armë dy herë që paraqet dashje eventuale më shumë bindëse dhe veprim të rrezikshëm. Veprimet që janë bërë pas të shtënave me armë që nuk ishin efektive dhe faktin që i pandehuri ka pasur dënim paraprak edhe pse ky dënim nuk lidhet drejtëpërdrejtë me llojin e njëjtë të veprave penale. Mosha.

Sa i përket veprës penale të përdorimit të armës:

Kalibrin e asaj arme që paraqet rrezik të mesëm. Faktin që ajo armë është përdorur për të kryer një vepër të rëndë penale. Dhe faktin që i pandehuri ka përdorur atë armë me vite të tëra pa leje.⁴

Trupi gjykues ka marrë në konsideratë këta faktorë lehtësues:

Ai vullnetarisht është paraqitur për ta lajmëruar veprën penale (asnjëherë nuk e ka mohuar se ka shtënë me armë). Ai ka familje (pesë fëmijë, njërin prej tyre me probleme

⁴ Shih vendimin e gjykatës së apelit të datës 25/04/2014 "Vepra penale mbajtje në pronësi, kontroll, posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve është vepër penale në vazhdimësi, pasha e së cilës varet nga rrethanat dhe sigurisht edhe nga kohëzgjatja e veprimit të paligjshëm. Është vërtetuar se Z.V. kishte në posedim një armë për një periudhë të gjatë prandaj fajësia e tij është vlerësuar në mënyrë adekuate më e madhe se sa do të ishte në rast se atë do ta kishte në posedim për një periudhë të shkurtër". [http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/judgments/criminal-proceedings/Court-of-Appeals/35-14/\(2014%2004%2025\)%20-%20JUD%20-%20Z%20V%20-%20CA%20-%20ENG.PDF](http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/judgments/criminal-proceedings/Court-of-Appeals/35-14/(2014%2004%2025)%20-%20JUD%20-%20Z%20V%20-%20CA%20-%20ENG.PDF)

shëndetësore). Pastaj, aftësinë e zvogëluar mendore që e ulë shumë paligjshmërinë e përgjegjësisë së tij personale. Së treti, faktin se ai ka vepruar me dashje eventuale jo drejtëpërdrejtë. Faktin që ai ka treguar qartazi keqardhje të sinqertë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në kuptim të veprës penale të vrasjes përpjekjet që ka bërë ai (pasi ka kuptuar se jeta e viktimës ishte në rrezik, për ta shpëtuar viktimën sipas dispozitës së nenit 30 KPK).

Sa i përket përdorimit të armës, pranimi i paraqitur i fajësisë dhe përdorimi i zakonshëm i armëve në Kosovë për shkaqe kombëtare dhe të veqanta.

Sa i përket veprës penale vrasje, kufijtë e dënimit janë: 5 deri 25 vite burgim (neni 45/1 KPK).

Sjellja e kundërligjshme e të pandehurit është në nivel të mesëm për të gjitha llojet e vrasësve. Por, gjendja personale dhe aftësitë zvogëluuese, zvogëlojnë dukshëm fajësinë e të pandehurit.

Sa i përket përdorimit të armës, aftësia e zvogëluar nuk është e rëndësishme sepse i pandehuri ka pasur pesë vjet për të menduar dhe për ta dorëzuar armën në polici. Andaj, dënimi duhet të reflektojë këtë nivelin e sipërm të fajësisë dhe kundërligjshmërisë.

Sipas neni 80, para. 1 dhe 2, nën-para 2.2 i KPK për të dy veprat e lartëcekura të S.I.t, trupi gjykues mori parasyshë lidhjen ndërmjet të dy veprave penale.

Ishte detyrë e trupit gjykues që kohën e z. S.I., të kaluar në paraburgim ta llogaris në dënimin me burg që i është shqiptuar atij.

6. Konfiskimi i instrumenteve të veprës penale

Arma është konfiskuar sepse ajo është përdorur për ta kryer veprën penale (neni 69 KPK).

Gjithashtu në këtë rast ajo armë është konfiskuar sipas procedurës ligjore dhe i pandehuri nuk ka demonstruar se posedon leje për të (nenet 4, paragrafi 1.2, 7, 10, 17, 33, të Ligjit nr. 03/L-143 Ligji për Armët).

Neni 38 i Ligjit për Armët thotë: “1. Arma/Arma e Zjarrit dhe municioni i konfiskuar gjatë procedurës penale apo gjatë procedurës kundërvajtëse do t’i dorëzohet

organit kompetent brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë”. Prandaj, sipas dispozitës së nenit 9 të Ligjit nr. 04.l.209 ky është vendimi i formës së pretë për veprën penale.

7. Shpenzimet

Trupi Gjykses e bazon vendimin e tij për shpenzimet e procedurës penale në dispozitën ligjore të cituara në dispozitiv. Sasia dhe proporcioni ndërmjet shumave të caktuara që i pandehuri është i obliguar t'i paguajë është caktuar duke marrë parasysh peshën e akuzave, gjendjen ekonomike të të pandehurit dhe pranimin e fajësisë për akuzën më të lehtë. Gjithashtu është marrë parasysh se R.S. është liruar nga akuza kundër tij.

*

* *

*

Mjeti ligjor: Dispozitat e nenit 398 (1) KPK personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë kundër Aktgjykimit brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e marrjes së një kopjeje të aktgjykimit.

Nënshkruar me datën 25 Nëntor 2014

Dukagjin Kërveshi

Procesmbajtës

Paulo Teixeira

Kryetari i Trupit Gjykses,

gjyqtar i EULEX-it

